



Forma / Prindor / Baza / Category	Drejtimi / Prerastje / Detyrimi / Destiny	28 - 04	2022	2	viti / god / year
Organ / Organ / Organ / Org-Unit	Nr. Prot / Pr. / Prot. No.	Shtesa / Pratje / Appendix		Sasia / Kolicina / Quantity	
SKIMSHUK	2488/2022			113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.241/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.241/2022 të datës 16.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 28.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa A.nr.241/2022 e datës 16.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë në pozitën "Koordinator i Zyrës Regjionale" në Mitrovicë, me datë 16.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër Ref.AUV-01-052/2022 të datës 03.02.2022 të Zëvendësuesit të Kryeshefit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 23.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa Këshilli me datë 04.04.2022 ka pranuar nga organi i punësimit shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1415/2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 16.03.2022; E-malin e datës 16.03.2022; Vendimin me numër

Ref.AVU-01-052/2022 të datës 03.02.2022; E-malin me numër të protokollit 1562/2022 të datës 24.03.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 155/2022 të datës 23.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1845/2022 të datës 04.04.2022 të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë; Vendimin me numër Ref.AUV.01-320/2018 të datës 05.09.2018 lidhur me transferimin e ankuesit;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi në bazë të Vendimit me numër Ref. AUV 01-320/2018 të datës 05.09.2018 të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë është transferuar nga pozita Koordinator i Zyrës Regjionale në Prishtinë në pozitën Koordinator i Zyrës Regjionale në Mitrovicë në kuadër të të njëjtës kategori funksionale dhe gradë. I njëjti me datë 16.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër Ref.AUV-01-052/2022 të datës 03.02.2022 të Zëvendësuesit të Kryeshefit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë duke pretenduar së janë shkelur të drejtat e 70 inspektoreve sanitare.

Kolegji ka shqyrtuar vendimin e goditur me ankesë dhe rrjedhimisht ka konstatuar se Zëvendësuesi i Kryeshefit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë me Vendimin me numër Ref.AUV-01-052/2022 të datës 03.02.2022, ka themeluar Komisionin par vlerësimin e kushteve dhe kritereve për dhënien e pëlqimeve sanitare për kategoritë e objekteve par qarkulluesit me shumice dhe pakicë par produkte dhe pajisje meridionale, institucioneve shëndetësorë jashtë spitalore, institucioneve arsimore dhe institucione të tjera, në përbërje nga kryesuese, anëtar dhe anëtari i trete inspektor sanitar nga regjioni përkatës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...", Kolegji vlerëson se me Vendimin me numër Ref.AUV-01-052/2022 të datës 03.02.2022 të Zëvendësuesit të Kryeshefit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit lidhur me marrëdhënien e tij të punës, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.241 /2022 e datës 16.03.2022, e parashtruar nga ankuesi është e papranueshme.

Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.



Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.241/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.



Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

